



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK**

**Raport mbi Diskutimin Publik për Propozim Strategjinë e Zhvillimit  
Ekonomik Lokal 2023-2025 për Komunën e Podujevës**

Hyrje

Bazuar në nenin 17, paragrafi 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna

**Nr. i protokolit: 15-401/04-0097624/22**

Podujevë, Nëntor 2022

Kuvendi i Komunës me datë 29.09.2022 ka nxjerr vendimin për vënie në diskutim publik të Draft Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal- SZHEL 2023-2025 të Komunës së Podujevës, nr.prot. 01-300/01-0084085/22.

Diskutimi publik ka zgjatur 30 ditë, nga data 05 tetor 2022 deri më 05 nëntor 2022. Ndërsa, debati publik me qytetarë është mbajtur më 13 tetor 2022 duke filluar nga ora 13:30, në sallën e mbledhjeve.

Gjatë diskutimit publik nuk kemi pranuar asnjë propozim, sygjërim apo vërejtje nga qytetarët qoftë në formë elektronike apo fizike. Ndërsa, në debatin publik me qytetarë kanë qenë të pranishëm 8 pjesëmarrës.

Të pranishëm në debatin publik me qytetarë për të diskutuar për draftin e SZHEL 2023-2025 ishin: Drejtori i DPZHE, z. Vigan Salihu, përfaqësuesja e kompanisë "Albo Group", prof. Albana Berisha dhe një numër i qytetarëve.

Kompania "Albo Group" e cila edhe e ka punuar Draft Strategjinë e ZHEL 2023-2025 ka prezantuar draftin në fjalë në pikat kryesore. Ata treguan se kjo draft strategji përbanë pikat kryesore që çdo draft strategji duhet të i ketë dhe se katër fazat në të cilat ka kaluar hartimi i saj janë:

1. Organizimi dhe konsolidimi i grupit punues
2. Analiza e gjendjes ekonomike lokale
3. Hartimi dhe zhvillimi i SZHEL.
4. Zbatimi dhe rishikimi i kësaj strategjie.

Përfaqësuesja e kompanisë "Albo Group" shpjegoi në pikat kryesore secilën fazë në të cilën ka kaluar hartimi i draft strategjisë së ZHEL. Ajo ka prezantuar një historik të shkurtër të komunës, pozitën dhe veçoritë gjeografike, popullsinë, vendbanimet, migrimin, arsimin, shëndetësinë e mirëqenien sociale, tregun e punës, shërbimet administrative, infrastrukturën dhe telekomunikacionin, rrjetin energjetik dhe shërbimet tjera komunale, kulturën dhe profilin ekonomik të Komunës së Podujevës.

Po ashtu, ajo ka prezantuar edhe analizën SWOT të draft strategjisë, ku tha se analiza SWOT është analiza e cila më së shumti përdoret në botë. Në rastin e draft strategjisë ajo është përdorur për të paraqitur gjendjen e komunës së Podujevës, duke i treguar dobësitë, përparësitë, mundësitë dhe rreziqet që i ka komuna e Podujevës.

Gjatë prezantimit, qytetarët patën mundësi të njoftohen edhe me shtojcat të cilat i përmbanë draft strategjia në fjalë dhe të cilat pasqyrojnë qëllimet dhe objektivat strategjike të komunës së Podujevës.

Në fund të diskutimit publik, drejtori i drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, z.Vigan Salihu, ftoi të gjithë qytetarët të kontribuojnë në pasurimin e strategjisë me idetë dhe sygjërimet e tyre qoftë përmes formës elektronike apo fizike. Mirëpo, në debatin publik që u mbajt me qytetarë nuk pati diskutime, pasi që ata thanë se do ta konsultojnë edhe njëherë materialin e draftit të SZHEL 2023-2025 dhe në qoftë se kanë diçka për të shtuar, ndryshuar ose hequr, do t'a paraqesin pranë DPZHE-së. Gjatë fazës së diskutimit publik janë dhënë rekomandime, plotësim/ndryshime nga drejtoritë përkatëse, ku janë harmonizuar projektet me KAB 2023-2025 dhe me prioritetet e të gjitha drejtorive, si rrjedhojë me datën 04.11.2022 është mbajtur edhe një takim përmbyllës mes kompanisë dhe drejtorëve të drejtorive për t'a finalizuar draftin e SZHEL.

Diskutimi publik për Draft Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 për Komunën e Podujevës ka përfunduar me datë 05.11.2022.

#### **Raportit i bashkangjiten:**

1. Vendimi për ngritjen e ekipit komunal në funksion të hartimit të SZHEL 2023-2025.
2. Vendimi për vënie në diskutim publik të Draftit të SZHEL 2023-2025.
3. Proccsverbali i diskutimit publik me qytetarë
4. Lista e pjesëmarrësve në takimin publik me qytetarë.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

## DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

### *Procesverbal i diskutimit publik në lidhje me Draft Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025*

Të enjtën me 13.10.2022 duke filluar nga ora 13:30 në Sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Podujevës u mbajt diskutimi publik më qytetarë lidhur me Draft Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 për Komunën e Podujevës.

Të pranishëm në takim ishin: Drejtori i DPZHE, z.Vigan Salihu, përfaqësuesja e kompanisë “Albo Group”, prof. Albana Berisha dhe një numër i qytetarëve.

Kompania “Albo Group” e cila edhe e ka punuar Draft Strategjinë e ZHEL 2023-2025 e prezantoi draftin në fjalë në pikat kryesore. Ata treguan se kjo draft strategji përbanë pikat kryesore që çdo draft strategji duhet të i ketë dhe se katër fazat në të cilat ka kaluar hartimi i saj janë:

1. Organizimi dhe konsolidimi i grupit punues
2. Analiza e gjendjes ekonomike lokale
3. Hartimi dhe zhvillimi i SZHEL
4. Zbatimi dhe rishikimi i kësaj strategjie.

Përfaqësuesja e kompanisë “Albo Group” shtjelloj në pikat kryesore secilën fazë në të cilën ka kaluar hartimi i draft strategjisë së ZHEL. Ajo prezantoi një historik të shkurtër të komunës, pozitën dhe veçoritë gjeografike, popullsinë, vendbanimet, migrimin, arsimin, shëndetësinë e mirëqenien sociale, tregun e punës, shërbimet administrative, infrastrukturën dhe telekomunikacionin, rrjetin energjetik dhe shërbimet tjera komunale, kulturën dhe profilin ekonomik të Komunës së Podujevës.

Po ashtu, ajo prezantoi edhe analizën SWOT të draft strategjisë, ku tha se analiza SWOT është analiza e cila më së shumti përdoret në botë. Në rastin e draft strategjisë ajo është përdorur për të paraqitur gjendjen e komunës së Podujevës, duke i treguar dobësitë, përparësitë, mundësitë dhe rreziqet që i ka komuna e Podujevës.

Gjatë prezantimit, qytetarët patën mundësi të njoftohen edhe me shtojcat të cilat i përmbanë draft strategjia në fjalë dhe të cilat pasqyrojnë qëllimet dhe objektivat strategjike të komunës së Podujevës.

Në fund të diskutimit publik, drejtori i drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, z.Vigan Salihu, ftoi të gjithë qytetarët të kontribuojnë në pasurimin e strategjisë me idetë dhe sygjerimet e tyre qoftë përmes formës elektronike apo fizike.

Të pranishmit u dakorduan që t'a konsullojnë edhe njëherë më hollësisht draftin e SZHEL dhe nëse kanë ndonjë vërejtje apo sygjerim do t'i dërgojnë përmes imell adresës.

Draft Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 është në diskutim publik deri më 5 nëntor 2022.

Data:

13/10/2022

Mbajtësi i procesverbalit:


Mimozë Restelica Sejdiu







Kuvendi i Komunës së Podujevës





**IVRIE**

საქართველოს მთავრობის განცხადებით, ქვეყნის მთლიანი შიდა პროდუქტის (საშუალო) ზრდა 2017 წელს შეადგინდა 3,5%. ეს მაჩვენებელი დაბალია, თუმცა მის მიღწევასთან დაკავშირებით მთავრობის განცხადებით, მნიშვნელოვან როლს ითამაშებს მთავრობის მიერ დაგეგმილი რეკონსტრუქციული პროგრამის განხორციელება. პროგრამის ფარგლებში დაგეგმილია სახელმწიფო ინვესტიციების ხარჯზე რეკონსტრუქციის სამუშაოების დასრულება, რაც ხელს შეწყობს ქვეყნის ეკონომიკის განვითარებას.

საქართველოს მთავრობის განცხადებით, ქვეყნის მთლიანი შიდა პროდუქტის (საშუალო) ზრდა 2018 წელს შეადგინდა 3,5%. ეს მაჩვენებელი დაბალია, თუმცა მის მიღწევასთან დაკავშირებით მთავრობის განცხადებით, მნიშვნელოვან როლს ითამაშებს მთავრობის მიერ დაგეგმილი რეკონსტრუქციული პროგრამის განხორციელება. პროგრამის ფარგლებში დაგეგმილია სახელმწიფო ინვესტიციების ხარჯზე რეკონსტრუქციის სამუშაოების დასრულება, რაც ხელს შეწყობს ქვეყნის ეკონომიკის განვითარებას.

Kavendi ნივეს







Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Lista e pjesëmarrësve në diskutimin publik për Draft Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 të mbajtur më 13.10.2022 në Sallën e Kuvendit Komunal

Nr. Ren.	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	MIRVETE MEROVCI	PODUJEVE	
2	GENC GASHI	Podujevë	
3	Xhevrië Begiri	Podujevë	
4	KOVACS KAROLT	KFOR	
5	ASDREN LLIJGALIU	PODUJEVË	
6	Bleta Ajvazi	Podujevë	
7	LIRIDONA PRALIMANI	PODUJEVË	
8	Verona Dibrani	Podujevë	
9			
10			
11			
12			
13			
14			